

NACIONAL

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

Shkrimtari Naum Prifti rrëfen kujtimet për poetin Lasgush Poradeci

Jeta e panjohur e Lasgushit

faqe 12



Kontributi i shqiptarëve për Greqinë, sipas historianit anglez, Xhorxh Finlei

Si grekët miratuan fustanellën shqiptare si kostumin e tyre kombëtar

faqe 14-15



EDITORIAL

Mardhënjet e Kosovës me ndërkombëtarët

Nga Skënder Buçpapaj




Është një e vërtetë absolute se në Kosovë ka një inflacion të tejskajshëm të pranisë ndërkombëtare. E tillë

është edhe e vërteta se në praktikën botërore nuk ka pasur dhe nuk ka një shembull të tillë të llojshmërisë së panumërt të pranisë ndërkombëtare të natyrës ushtarake dhe civile, si dhe të hibrideve të dala nga shartimet e ndërthurjet mes këtyre. Gjatë gjithë këtyre viteve të kësaj dukurie, ndonëse gjithnjë në shtim të llojshmërisë së tyre gjithfarëshe, megjithatë, nuk kemi parë ndonjëherë sadopak ndonjë përplasje të drejt-përdrejtë në radhët e ndërkombëtarëve

Faqen 21

Zgjedhjet lokale në Mal të Zi dhe shqiptarët

Nga Ruben Avxhiu, New York



Të dielën që shkoi u mbajtën zgjedhjet lokale në Malin e Zi dhe rezultatet sigurisht kanë qenë të

hidhura për dikë e të ëmbla për dikë tjetër. Si rrallë më parë, në qendër të vëmendjes për shqiptarët ka qenë beteja zgjedhore në Malësi. Rajoni me qendër Tuzin është përfshirë prej ditësh nga ethe politike që kishin të bëjnë më fushatën por jo vetëm me të.

Faqe 22

Poeti i njohur tropojan flet për miqësitë me Agollin, Kadarenë dhe Qosen...

Hamit Aliaj: Si e kam njohur kryeministrin Berisha

Intervistoi: Albert Zholi

faqe 2-3



Juliana Pasha, në "Eurovision 2010"

Paraqitje dinjitoze e Shqipërisë me kompozimin e Gjebresë

Faqe 23

Në BRENDËSI

Themel dhe shpirt

Esse nga Visar Zhiti

faqe 6

Nobelisti Euxhenio Montale

Studim nga Egla Kokalari

faqe 10

Amaneti i fundit i Faik Konicës

Dossier nga Dr. Isak Shema

faqe 18

Poezia e Gjekë Marinajt

Kritikë nga Mimoza Erebara

faqe 9

Gjuha shqipe në Maqedoni

Dossier nga Prof. Dr. Avzi Mustafa

faqe 17

Tregime nga: Faik Ballanca, Merlin Tushe

faqe 7-20

Kishat serbe të ndërtuara mbi kishat shqiptare

Studim nga Dr. Jahja Drançolli

faqe 11

"I shilbuti"

Reportazh nga Gani Tërshnjaku

faqe 4

Poezi nga: Eduart Hirc, Sabile Keçmezi, Lida Lazaj, Pilo Llaguri, Besnik Bedollari, Endri Vela

faqe 5-19

ARMO Albanian Refining & Marketing of Oil

**PËR HERË TË PARË
EURODIESEL
I STANDARTEVE EUROPIANE**

PCALBANIA
Broker Sigurimesh

Aty ku siguria është Art

Për vëllimin poetik "Lutje në ditën e tetë të javës" të Gjekë Marinaj

Kode poetike dhe lexues empirik



Në foto: Mimoza Erebara

"Gjek Marinaj na tregon me një elegancë intelektuale pikërisht përkatësinë tonë gjenetike dhe e mbron fort atë. Nga një këndvështrim ai është një konservator i pandreqshëm, dhe shumë krenar për këtë gjë. Dashuria, Jeta, Lutja, Lufta, Paqja, Universi, Kufijtë Njerëzorë dhe ata Shpirtërorë, Familja, Nëna, Vëllai, Meditimi, Zoti, - në fakt janë rrethi ku sillet çdo komb sipas mënyrës së vet."

Nga MIMOZA EREBARA

Poezia padyshim që është kod. Kod herë lehtësisht i deshifrueshëm dhe herë i padeshifrueshëm. Kode që na vijnë përmes simboleve dhe metaforave. Që na çojnë drejt njohjes. Një njohje që vjen nga një akt imagjativ drejt realitetit. Dhe kështu ne njohim njeriun dhe idetë e tij, njeriun dhe ndjenjat e tij. I zbërthejmë kodet poetike që na ofrohen dhe shijojmë madhësitë e të menduarit dhe hyjnitë e ndjenjës. Është një proces që ndodh pavarësisht prej nesh, mjafton që para nesh të jetë një tekst poetic. Nuk është e nevojshme që një njeri të ndryshojë këto kode, është njëllor sikur kodet e AND-së. Që janë të pandryshueshme dhe na përcaktojnë jetën. Kështu është edhe kodi poetic, përcakton poezinë dhe përkatësinë intelektuale të autorit. Një kod sa është individual aq edhe universal, sa është i një përkatësie etnike dhe kombëtare aq edhe i mbarë njerëzimit. Problemi që shtrihet në rrafshin teorik, në këtë rast është sa i deshifrueshëm është ky kod në raport me lexuesin. Dhe pyetja tjetër që shtrohet është, sa është i përgatitur ky lexues për të lexuar këto kode, që në librin e Gjekë Marinaj vijnë përmes një simbolike e metafore krejt të veçantë. Të jesh pjesë e një etnie, e një përkatësie kombëtare, pavarësisht vendit se ku jeton dhe këtë përkatësi ta shpërfaqësh me forcë, sigurisht që për mua personalisht përbën një vlerë të padiskutueshme. Dhe që autori e realizon ndoshta në mënyrë të pavarur, intuitive, si pjesë e pandashme e një simbolike të shtresëzuar thellë në ndërdijën e tij emotive dhe mendore. Dihet që populli nuk duron kur i preken format e besimit, cilido qoftë ai dhe ruan me xheloz kodet e tij të hershme dhe të ndërhysh në kodet e tij simbolikë është pothuaj e pamundur. Por jo përgjithmonë. E veçanta që vërej nga teksti i Marinaj është sfida që ai i shpall pikërisht këtij "kodi". Duke luajtur me këto kode. Duke u dhënë vendin që u takon në simbolikën e përgjithshme, duke zbuluar para lexuesit atë që ai e mbart brenda vetes. Të manipulosh mendjet e njerëzve dhe të spekulosh me emocionin e tyre, është e thjeshtë. Mjaft të hedhësh në tregun e ideve, atë që ti e quan origjinale dhe ta shesësh për të tillë. Duke qenë që njerëzit janë të prirur për të besuar dhe për t'u kënaqur pa shumë mendime, rezultati zakonisht është i garantuar. Merren disa "kode", të sipërfaqshme dhe u jepet lexuesit, i cili nga ana e tij në masë, është tejet empirik, dhe xhongerizimi i këtyre kodeve i impresionon aq shumë, sa besojnë pikërisht atë që u serviret. Jemi dëshmitarë të kësaj rruge që ndiqet nga autoreë të caktuar dhe po ashtu jemi edhe dëshmitarë të "suksesit" të tyre. Por në garën me Kohën, në garën me Traditën, në garën me letërsinë e vëretetë dihet që ata janë të humbur. Gjek Marinaj në librin e tij këto koncepte i ka mëse të qarta, sepse në asnjë varg të tij nuk ka spekulim. Vargjet e tij janë të sinqerta, të ndjera, ruajnë traditën me forcë duke na e dhënë kodifikimin tonë etnik e kombëtar nën një frymë krijtësisht të re, por jo të pakuptueshme. Gjek Marinaj na tregon me një elegancë intelektuale pikërisht përkatësinë tonë gjenetike dhe e mbron fort atë. Nga një këndvështrim ai është një konservator i pandreqshëm, dhe shumë krenar për këtë gjë. Dashuria, Jeta, Lutja, Lufta, Paqja, Universi, Kufijtë Njerëzorë dhe ata Shpirtërorë, Familja,

Nëna, Vëllai, Meditimi, Zoti, - në fakt janë rrethi ku sillet çdo komb sipas mënyrës së vet. Janë rrethi ku sillet edhe poezia e Gjekë Marinaj. Janë ushqimi i kësaj poezie. Janë një ushqim që na ve përpara disa veti të autorit si një qenie njerëzore në rradhë të parë, dhe si poet më pas. Dhe këto vlera kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ato ideale të brendshme, që e bëjnë Marinajn më humanist, dhe i japin një përmasë shumë më të gjerë se sa thjesht vetvetja. Është një rreth idealësh etike që e mbajnë poezinë e Marinaj në këmbë dhe po të lexojmë me kujdes lënda etike më e dukshme sigurisht që është atdheu. E veçanta e interpretimit të kasaj lënde, padyshim është stili me të cilin na vjen kjo lëndë. Nuk ka poet që nuk shkruan për atdheun. Që nuk i kush-ton pjesë të veçanta, e nganjëherë të gjithë krijimtarinë atij. Por tek Marinaj kjo vjen me një stil tejet elegant, sikur e kemi vërejtur edhe më parë, një elegancë që qëndron në një zbërthim tepër interesant. Pra Marinaj duke qenë qytetar i botës, është edhe qytetar i atdheut të tij. Ky qëndrim ideomocional i jep atij të drejtën që të ketë një këndvështrim original të vlerave, të kodeve kombëtare. Kodet nga ana e tyre nuk janë vetëm përcaktime simbolike të një kombi më gjerë, dhe të poetit më ngushtë. Kodet Poetike janë Art. Dhe arti nuk është vetëm Natyrë por edhe ndjenjë, fantazi, tek e fundit ai ekziston pikërisht prej përsiatjes, prej ndjenjës dhe fantazisë. Artit i pëlqen të ndjejë se si Natyra e ngacmon, se si Natyra e bën të mendojë dhe se si ia zbut zemrën, se se e bën më të hapur për të gjithë. Arti është Shpirti i artistit, është lënda e parë e papërpunuar e tij që na vjen me gjithë madhësitë e çastit sublim. Sublimitet që padyshim na çon drejt asaj që është e pashmangshme drejt besimit. Është besimi pastaj që drejton, krijon dhe ruan me fanatizëm edhe vetë Kodet. Që i trashëgon me skrupulozitet me dashurinë e një Ati. Poezia e Marinaj ka besim. Poezia e Marinaj drejtohet nga besimi. Megjithatë po të lexosh, pothuaj në një sërë poezish, ai na bën me dije se ka një marrëdhënie të veçantë me shkencën. Duket si një dashuri e pashpallur mes tyre, por që kuptohet lehtësisht. Pasi asnjëra palë nuk bën përpjekjen më të vogël për ta fshehur këtë marrëdhënie. Por Marinaj edhe këtë marrëdhënie e çon në hullinë e Kodifikimit Filozofik, në hullinë e Etikës, Moralit, Artit. Pra i jep një kuptim, kuptimin që ai do, duke dëshmuar kështu se ai qëndron në anën e poetëve që jo vetëm beson në Artin e tij, por që ia dhuron jetën kultit të tij. Duke përmasuar Artin dhe duke e shndërruar brenda vetes nga një luks, në një nevojë, duke e shndërruar në një vlerë etike parësore. Gjë që pastaj e çon e vetë drejt kodifikimit dhe çkodifikimit të simboleve, fantazisë, gjithë vlerave që mbart një filozofi etnikisht e përcaktuar, por edhe një filozofi e përbotshme. Është një dualitet (por jo rivalitet!) që vetëm sa e ngre poezinë Marinaj në rrafsh të larta të të kuptuarit metafizik të një realiteti, duke i dhënë atë përmasë që poezia e kërkon filozofinë. Duke u rrekur për të kuptuar atë që është esenciale tek qenia njerëzore. Duke e ndjekur këtë njeri në rrjedhat e jetës, nëpër të gjithë

ritmin e kalimit të tyre, sa nga etika e morali, sa tek besimi dhe feja, sa tek fantazia dhe inteligjenca, e sa tek kritika dhe gjyqësia e fakteve njerëzore dhe fakteve të jetës. Sa tek e ditura dhe e mirëditura, sa tek e mistershmeja, sa tek materialja e sa tek shpirti, tek fshehtësia e tij dhe e gjithë proceseve që e krijojnë po atë vetë. Dhe në çastin që pranojmë dhe pohojmë se poezia është krijim, po në këtë çast kemi pranuar dhe pohuar me forcë karakterin ndërtues të saj, kemi pohuar se poezia është një interpretim i mistereve të jetës, të cilët nga ana e tyre, nuk bëjnë gjë tjetër, veçse pjellin poezi. Bëjnë që vetë poezia të ekzistojë, shënojnë qëllimin dhe idenë e ekzistencës së poezisë. Ku ndodh rëndom që një lexues empirik të habitet nga guximi i hipotezave që mund të jenë të vjetra sa ç'janë edhe të reja, - sikur vetë jeta! - Mund të ndalem gjatë në çështje të metrikës apo të stilit në përgjithësi. Por e tërhequr më shumë nga diçka tjetër do ta anashkaloj këtë pikë duke ua lënë në dorë stilistikës. Në fakt ajo që më tërhoqi dhe më bëri të mendoj gjatë për këtë libër me poezi është këndvështrimi. Është mënyra se si autori e ka perceptuar realitetin, mënyra se si i ka ndërtuar ai marrëdhëniet me me të dhe me fantazinë. Mënyra se si ai është afruar

drejt kodeve dhe se si i ka deshifruar ato, se si i ka interpretuar ato. Duke ruajtur në mënyrë të shkëlqyer ekuilibret mes vetjakes dhe universale, mes shkencës dhe filozofisë, mes intelecencës dhe shpirtit, mes ndjenjës dhe medimit rreth saj, dhe shumë raporte të tjera që janë të pranishme në vargjet e Marinaj. Pra e thënë me një fjalë kemi të bëjmë me një poezi sa moderne, aq edhe tradicionale. Por modernja e saj qëndron dhe rrjedh pikërisht prej koncepteve të qarta që ai ka në raport me këtë realitet të cilin e sjell sa në një formë metafizike, aq edhe në një formë reale, aq edhe me shumë drejt një fantazie. Janë këto këndvështrime që përbëjnë risinë e kësaj poezie, e bëjnë atë të veçantë në letrat shqipe. Një poezi që nuk mud ta "kapërdish", nëse nuk di të lexosh, nëse nuk di kodet e tua. Poezia e Gjekë Marinaj është si një çelës, që hap e mbyll dyer të misterit, hyjnore, madhësitë së njeriut dhe universit, që na tregon sa mall kemi brenda vetes, sa të brishtë jemi, se si në mënyrë gati të pavullnetshme, jetojmë mes kodeve tona të mbartura dhe se si konvertohemi intelektualisht dhe shpirtërisht në kohët moderne duke kërkuar të shkojmë më larg, atje ku kufijtë nuk ekzistojnë.

